



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K2/E37-6 Prot.
Nr. Dok. 202500803/7

Tiranë 29/04/2025

Lënda: *Rekomandim përgjithësues për zbatimin e Kodit të Procedurës Administrative, lidhur me formën e urdhrit të drejtorit të IEVP-së si dhe për zbatimin e rregullave mbi trajtimin e të burgosurit gjatë qëndrimit në mjedisin e veçimit (rasti i të paraburgosurit E. S.).*

IEVP MINE PEZA
Tiranë

Për dijeni: **Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve**
Tiranë

Të nderuar,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë¹ i paraburgosuri E. S., i cili pretendon për sa më poshtë vijon:

- Është vendosur pa të drejtë nën regjimin e mbikëqyrjes së veçantë;
- Është mbajtur në kundërshtim me parashikimet ligjore, në mjedisin e veçimit pa u mbledhur Komisioni Disiplinor dhe pa u dhënë një masë disiplinore. Shkelja e referuar nga raporti i incidentit të datës 26.09.2024, nuk përbën shkelje të rëndë sipas përcaktimeve të nenit 62 të Ligjit 81/2020, në mënyrë që të justifikohet mbajtja e tij në mjedisin e veçimit.
- Kushtet e mjedisit të veçimit kanë qenë degraduese, të padizinfektuara dhe me lagështirë.

¹ Ankesa është regjistruar në institucionin tonë në datën 30.10.2024.

- Gjatë qëndrimit në dhomën e veçimit nuk i janë lejuar rroba për më shumë se 48 orë; nuk i janë lejuar sendet personale të nevojshme; i janë ndërprerë takimet me familjarët për 14 ditë; i janë kufizuar telefonatat; i janë mohuar ekzaminimet mjekësore; i është mohuar shërbimi stomatologjik; nuk i është siguruar ushqim, përveç 5 rasteve.

I paraburgosuri E. S. na ka vënë në dispozicion raport-incidentin e datës 26.09.2024 dhe Vendimin Nr. 4324 Prot., datë 10.10.2024, për vendosjen e tij nën regjimin e mbikëqyrjes së veçantë, ku rezulton se:

Në datën 26.09.2024, katër punonjës të policisë së grupit të sigurisë së IEVP “Mine Peza”, kanë raportuar se i paraburgosuri E. S. ka përdorur ndaj tyre fjalë fyese dhe kërcënuese, pasi ai nuk i është bindur urdhrit për t’u kontrolluar dhe për të dalë në ajrim, por ka tentuar të shkojë të takojë disa të paraburgosur të tjerë te zgara a katit të parë. Në këto kushte ky i paraburgosur është dërguar në mjedisin e veçimit. Bazuar në raportin e Komisionit të Rrezikshmërisë të të burgosurve të IEVP “Mine Peza”, drejtori i IEVP-së, ka vendosur caktimin e të paraburgosurit E. S. në regjimin e mbikëqyrjes së veçantë, për një periudhë 3 mujore, duke llogaritur fillimin e kësaj mase nga data 26.09.2024.

I paraburgosuri E. S., i kundërshton faktet e paraqitura në raport-incidentin e përpiluar nga punonjësit e policisë, duke u shprehur se incidenti ka qenë i stisur nga dy punonjës të policisë, të cilët e kanë provokuar duke e penguar dhe derdhur kafënë, kur ai në shenjë respekti iu drejtua një kolegut të tyre, për t’i ofruar një cigare. Për këtë arsye ai është irrituar, ka ngritur zërin dhe i është drejtuar punonjësve të policisë me fjalët: *“S’i ke sytë në ballë? Fol si njeri se marr vesh me fjalë, pa më prekur me dorë! S’na lat rehatë, s’na latë!”*. Gjithashtu, një nga punonjësit e policisë i ka thënë: *“Ta shqyej kafkën”* dhe ai i është përgjigjur *“Takohemi jashtë, ma shqyej kafkën”*.

Pasi u njohëm me këto pretendime, referuar nenit 13, paragrafi i parë, të Ligjit nr.8485, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se: *“Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike”*, vlerësuam se ato përmbajnë elemente për t’u pranuar për shqyrtim nga ana e institucionit tonë dhe fillimin e hetimit administrativ.

Me shkresën tonë Nr.K2/E37-2 Prot., datë 31.10.2024, kemi kërkuar nga institucioni juaj të infomohemi lidhur me trajtimin e të paraburgosurit E. S. gjatë qëndrimit në mjedisin e veçimit, nëse janë vendosur kufizime të të drejtave gjatë qëndrimit të tij në këtë mjedis dhe nëse ishte urdhëruar nga drejtori, veçimi i të paraburgosurit deri në mbledhjen e komisionit disiplinor, në zbatim të nenit 63, pika 1 të Ligjit Nr. 81/2020.

Gjithashtu, kemi kërkuar të na vihet në dispozicion dokumentacioni i procedurës disiplinore për këtë rast dhe fletë të kartelës klinike të të paraburgosurit E. S. apo të

regjistrit ku janë shënuar kontrollet mjekësore të mjekut të IEVP-së apo mjekëve specialistë, gjatë kohës së qëndrimit të tij në mjedisin e veçimit.

Referuar përgjigjes që kemi marrë nga institucioni juaj me shkresën Nr. 4696/1 Prot., datë 13.11.2024 dhe dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton sa më poshtë vijon:

Në datën 26.09.2024, i paraburgosuri E. S., është përfshirë në një konflikt verbal me punonjës të policisë së IEVP “Mine Peza”, në drejtim të të cilëve ka përdorur fjalë fyese dhe kërcënuese, dhe për këtë arsye ai është shoqëruar në mjedisin e veçimit në këtë datë.

I paraburgosuri E. S., ka kundërshtuar fillimisht shoqërimin e tij në mjedisin e veçimit, duke përdorur sërish fjalë fyese dhe kërcënuese, dhe për pasojë është ndërprerë veprimtaria në IEVP. Më pas ai është bindur me fjalë të shoqërohet në mjedisin e veçimit, pa qenë e nevojshme përdorimi i forcës.

Bazuar në raport incidentin nr. 4109 Prot., datë 26.09.2024, të nënshkruar nga 5 punonjës të policisë, ka filluar procedimi disiplinor për të paraburgosurin E. S., me Urdhrin Nr. 4109/1, datë 27.09.2024 të Drejtorit të IEVP-së.

Në datën 27.09.2024, i paraburgosuri E. S. është dëgjuar para Komisionit të Disiplinës, ku ai është shprehur si vijon: *“Kam qenë i ngarkuar moralisht, kam dalë për ajrosje dhe kam dashur që të përshëndes bashkëvuajtësit e katit të parë aty te zgara. Punonjësi i policisë duke më ndaluar më ka derdhur kafën dhe këtu nisi keqkuptimi. Siç ju shpjegova kam qenë i ngarkuar për probleme të mijat personale dhe në nerva e sipër kam lëshuar ndonjë fjalë më shumë. Ju kërkoj ndjesë për sjelljen time policëve”*.

Anëtarët e Komisionit të Disiplinës e kanë konsideruar qëndrimin e të paraburgosurit E. S., para këtij komisioni si: *“indiferent ndaj shkeljes së kryer dhe justifikues”*.

Komisioni i Disiplinës ka analizuar edhe pamjet e kamerave të sigurisë, duke dhënë përshkrimin si vijon: *“shikohet qartë se i paraburgosuri E. S., në momentin që ka zbritur nga kati 2, për të dalë në ajrosje, nuk i bindet urdhërit të punnjësve të policisë për t’u kontrolluar dhe për të dalë në ajrosje, por vazhdon të ecë në drejtim të zgarës së katit të parë, për të komunikuar me të paraburgosur të tjerë aty. Më pas vihet re që i nervozuar i paraburgosuri E. S. kundërshton dhe ofendon punonjësit e policisë dhe grupin e sigurisë”*.

Anëtarët e Komisionit të Disiplinës kanë vendosur pezullimin e procedurës disiplinore, me shkresën Nr. 4145 Prot., datë 30.09.2024, dhe kalimin e këtij rasti për shqyrtim Komisionit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë të të burgosurve në IEVP “Mine Peza”. Ky Komision, ka propozuar vendosjen e të paraburgosurit E. S. në regjimin e mbikëqyrjes së veçantë, për një periudhë 3 muaj, me raportin Nr. 4145/1 Prot., datë 30.09.2024.

Raporti i Komisionit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë të të burgosurve në IEVP “Mine Peza” është lënë në fuqi nga komisioni përkatës në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, me Vendimin Nr. 1811, datë 09.10.2024.

Bazuar në dokumentacionin e praktikës disiplinore dhe raportin e Komisionit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë të të burgosurve, me Vendimin Nr. 4324 Prot., datë 10.10.2024, drejtori i IEVP “Mine Peza” ka vendosur të paraburgosurin E. S. në regjimin e mbikëqyrjes së veçantë, për një periudhë 3 muaj, duke përllogaritur fillimin e afatit nga data 26.09.2024, kur ky i paraburgosur është shoqëruar në mjedisin e veçimit.

I paraburgosuri E. S. ka qëndruar në mjedisin e veçimit të IEVP “Mine Peza”, nga data 26.09.2024 deri në datën 17.10.2024, kur ai është transferuar në IEVP “Jordan Misja”, për t’u vendosur në regjimin e mbikëqyrjes së veçantë, për mungesë të këtyre mjediseve në IEVP “Mine Peza”.

Për të parandaluar pasojat nga sjellja e të paraburgosurit E. S. dhe të garantuar sigurinë në IEVP, është urdhëruar shoqërimi i tij në mjedisin e veçimit, në datën 26.09.2024, kur ka ndodhur incidenti. **Nga ana jonë është kërkuar të na vihet në dispozicion kopje e urdhërit të shoqërimit të të paraburgosurit E. S., në mjedisin e veçimit, në datën 26.09.2024, por ky urdhër nuk na është dërguar dhe në përgjigjen e IEVP Mine Peza, nuk sqarohet nëse urdhri ka qenë verbal apo me shkrim.**

Në datën 27.09.2024, kur është mbledhur Komisioni i Disiplinës, Dr. M. D., Shefe e Shërbimit Shëndetësor, i ka vënë në dispozicion Komisionit, raportin Nr. 4109/2 Prot., datë 27.09.2024, mbi gjendjen shëndetësore të të paraburgosurit E. S., ku ka shënuar se: *“I paraburgosuri ka qenë hospitalizuar në QSB për dg. _____. Aktualisht pa terapi”*.

Po sipas shpjegimit të IEVP “Mine Peza”, nga stafi infermieror, është ndjekur 24 orë gjendja shëndetësore e të paraburgosurit E. S., gjatë kohës së qëndrimit të tij në mjedisin e veçimit dhe është kërkuar konsultë nga mjeku IEVP-së në datën 03.10.2024 dhe 07.10.2024, por në datën 03.10.2024, i paraburgosuri ka refuzuar të realizojë konsultën.

Pavarësisht këtij shpjegimi, IEVP “Mine Peza”, nuk na ka vënë në dispozicion kopje e kartelës klinike të të paraburgosurit E. S. apo të regjistrimit ku janë shënuar kontrollet mjekësore të mjekut të IEVP-së ose të mjekëve specialistë, gjatë kohës së qëndrimit të tij në mjedisin e veçimit, megjithëse i kemi kërkuar këto dokumente me shkresën nr. K2/E37-2 Prot., datë 31.10.2024.

Bazuar në librin e regjistrimit të futjes së ushqimeve e të kontrollit të familjarëve, rezulton që në datën 10.10.2024, nga ana e familjarëve të të paraburgosurit E. S. janë futur ndërresa, paketa cigare dhe kartë telefoni. Gjithashtu, rezulton se në datën 14.10.2024, i paraburgosuri E. S. ka kryer takim fizik me nënën, gjyshin, një kushëri, nga të cilët janë dorëzuar edhe ushqime. **Për sa i përket periudhës 14 ditore, nga data 26.09.2024, kur i paraburgosuri E. S. është dërguar në mjedisin e veçimit, e deri në datën 10.10.2024,**

kur ka dalë vendimi për vendosjen e tij në regjimin e mbikëqyrjes së veçantë, nuk na është dhënë informacion nëse është lejuar i paraburgosuri për të kryer telefonata apo për të marrë takim me familjarët.

IEVP “Mine Peza”, shprehet se, gjatë qëndrimit në mjedisin e veçimit, i paraburgosuri E. S. është trajtuar sipas parashikimeve ligjore duke u furnizuar me 3 vakte ushqim nga ana e IEVP-së dhe e familjarëve si dhe me veshmbathje për përdorim personal, të sjella nga familja.

Vlerësimi i Institucionit të Avokatit të Popullit.

1. Rregullat për vendosjen e të burgosurit në mjedisin e veçimit dhe kufizimet që mund të caktohen në këto raste parashikohen në Ligjin Nr. 81/2020 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*.

Më konkretisht, në nenin 64, pika 3, parashikohet se: *“I burgosuri ndaj të cilit është dhënë një masë disiplinore, në përputhje me shkronjat “b” dhe “ç” të pikës 1 të këtij neni², vendoset në dhomat e veçimit...”*.

Pra, si rregull, i burgosuri vendoset në dhomën e veçimit pasi është dhënë masa disiplinore.

Në nenin 63 të Ligjit Nr. 81/2020³, parashikohet si përjashtim, se i burgosuri mund të vendoset në dhomën e veçimit, si masë parandaluese, deri në mbledhjen e komisionit disiplinor, **vetëm për shkelje shumë të rënda**, me qëllim garantimin e sigurisë, dhe me urdhër të drejtorit të IEVP-së.

Referuar përgjigjes të dërguar nga IEVP “Mine Peza” dhe dokumentacionit bashkëlidhur, ka rezultuar se, i paraburgosuri E. S. është dërguar në dhomën e veçimit në datën 26.09.2024, kur ka ndodhur incidenti, para se të mblidhej dhe të shprehej Komisioni i

² 1. Për shkeljet disiplinore zbatohen këto masa:

a) këshillim individual;

b) përjashtim nga veprimtari të përbashkëta deri në 10 ditë;

c) përjashtim nga ajrosja në grup deri në 10 ditë;

ç) përjashtim nga veprimtaritë e përbashkëta deri në 14 ditë.

³ Neni 63 (Masat parandaluese)

1. Drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale mund të urdhërojë veçimin e të burgosurit vetëm për shkelje shumë të rënda disiplinore, sipas parashikimeve të nenit 62 të këtij ligji, duke e vendosur në mjediset e veçimit deri në mbledhjen e komisionit disiplinor. Këto mjedise duhet të respektojnë standardet minimale që zbatohen për qëndrimin e të dënuarve.

2. Masa parandaluese ka si qëllim garantimin e sigurisë në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale dhe parandalimin e dëmtimeve ose pasojave që mund të vijnë nga sjellja ose veprimet e të burgosurit.

3. Masa parandaluese vendosen pa diskriminim dhe duhet të jenë në proporcion me situatën dhe nivelin e rrezikut.

Disiplinës, me qëllim për të parandaluar pasojat nga sjellja e tij dhe për të garantuar sigurinë në IEVP, por urdhri i dhënë për këtë masë nuk ka marrë formë të shkruar, sikur edhe kërkohet në Kodin e Procedurës Administrative, për aktet administrative të organit publik.

Më konkretisht, referuar nenit 3, të Kodit të Procedurës Administrative, *“Akti administrativ individual” është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete”*.

Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, akti administrativ ka formë të shkruar në letër ose elektronike, verbale, ose çdo formë tjetër të përshtatshme. Organi publik është i detyruar të konfirmojë pa vonesë përmbajtjen e aktit verbal, në formë të shkruar në letër ose elektronike⁴. Konfirmimi, në formë të shkruar, duhet të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 99 të Kodit të Procedurës Administrative, ku përcaktohet përmbajtja e aktit administrativ.

2. Gjatë qëndrimit të të paraburgosurit E. S., në mjedisin e veçimit, nuk provohet se vizitat mjekësore janë kryer dhe dokumentuar. Në mungesë të dokumentacionit provues, nuk arrihet të provohet se është zbatuar detyrimi ligjor i organit, i parashikuar në pikën 7, të nenit 64 të Ligjit Nr. 81/2020, ku përcaktohet se: *“Zbatimi i masës disiplinore të përjashtimit nga veprimtaritë e përbashkëta i nënshtrohet kontrollit të përditshëm mjekësor”*.

Veprimi i parregullt i të paraburgosurit E. S. rezulton të jetë kryer, ndërkohë ka nevojë që dokumentacioni i procedurave dhe zbatimi i të drejtave të të burgosurve të ndodhur nën masën disiplinore, duhet të mbetet prioritet i veprimtarisë së IEVP-së.

3. Për periudhën 14 ditore, nga data 26.09.2024, kur i paraburgosuri E. S. është dërguar në mjedisin e veçimit, e deri në datën 10.10.2024, kur ka dalë vendimi për vendosjen e tij në regjimin e mbikëqyrjes së veçantë, **nuk** na është dhënë informacion nëse është lejuar i paraburgosuri për të kryer telefonata apo për të marrë takim me familjarët. Bazuar në librin e regjistrimit të futjes së ushqimeve e kontrollit të familjarëve, ku keni referuar në përgjigjen tuaj, rezulton që në datën 10.10.2024, nga ana e familjarëve të të paraburgosurit E. S. janë futur ndërresa, paketa cigare dhe kartë telefoni. Gjithashtu, rezulton se në datën 14.10.2024, i paraburgosuri E. S. ka kryer takim fizik me nënën, gjyshin, një kushëri, nga të cilët janë dorëzuar edhe ushqime. Në mungesë të dokumentacionit, për periudhën 26.09.2024 – 10.10.2024, kur i paraburgosuri E. S. ndodhej në mjedisin e veçimit, në pritje të përfundimit të procesit disiplinor, nuk arrihet të provohet që ai të ketë kryer telefonata me familjarët dhe të ketë marrë takim me ta. Edhe në rastet kur i burgosuri është duke shlyer masën disiplinore në mjedisin e veçimit, atij duhet t’i garantohet të paktën një herë kontakt me anëtarët e familjes, bazuar në pikën 7, të nenit 64, të Ligjit nr. 81/2020.

⁴ Neni 98 i Kodit të Procedurës Administrative.

Në pikën 2, të nenit 8, të Ligjit Nr. 81/2020 parashikohet se: *“Të drejtat e të burgosurit, sipas këtij ligji, mund të kufizohen në minimumin e nevojshëm dhe vetëm në përmbushje të një qëllimi të ligjshëm në rastet dhe sipas kriterëve të parashikuara në këtë ligj”*.

Referuar nenit 49, pika 9, të Ligjit 81/2020, e drejta e të paraburgosurit ose të të dënuarit për biseda telefonike, kufizohet nga drejtori i IEVP-së, me vendim të prokurorit ose gjykatës.

4. Për sa i përket ankesës të të paraburgosurit E. S., mbi kushtet e mjedisit të veçimit, i cili kanë qenë degradues, i padizinfektuar dhe me lagështirë, kujtojmë se, në përfundim të inspektimit të datës 28.02.2024, Institucioni i Avokatit të Popullit, ju është drejtuar me shkresën Nr.K4/I14-2 Prot., datë 28.06.2024, ku ka adresuar gjetjet e inspektimit, dhe ka rekomanduar ndër të tjera, marrjen e masave të menjëhershme për ruajtjen e higjenes dhe kushteve higjeno-sanitare në mjediset e brendshme të banimit të të paraburgosurve, përfshirë mjedisin e observimit dhe të veçimit.

Gjithashtu, në raport-inspektimin e datës 28.02.2024, është vënë në dukje se, IEVP “Mine Peza”, është një institucion i ndërtuar në vitin 1930 dhe për këtë fakt mbetet në tërësinë e tij i amortizuar dhe me prani të lartë të lagështirës.

Në përgjigje të këtij rekomandimi, ju jeni shprehur në shkresën tuaj Nr.2911/1 Prot., datë 06.08.2024, se: *“Ka qenë prioritet i punës tonë dhe në mënyrë të vazhdueshme kemi organizuar lyerjen me gëlqere të gjitha dhomave të banimit si dhe ambjenteve të tjera të përbashkëta si me gëlqere dhe bojë vaji. Është sistemuar dhe rregulluar dhoma e këshillimit, dhomat e takimit me familjarët, avokatët etj. Gjithashtu, në mënyrë të vazhdueshme kemi bërë ndërhyrje dhe riparime në nyjet hidrosanitare dhe e ndjekim me vëmendje të shtuar për krijimin e kushteve sa më optimale për jetesë. Dizinfektimi i ambienteve është kryer dhe kryhet në mënyrë periodike, sipas planifikimit dhe kontraktimit që kemi për këtë qëllim, por edhe ndërhyhet rast pas rasti kur konstatojmë nevojën e tij me qëllim ruajtjen në parametrat e duhura të kushteve higjeno-sanitare”*.

Pavarësisht masave të marra nga IEVP-ja, për të përmirësuar kushtet e jetesës në regjimin e brendshëm të të burgosurve, godina vazhdon të jetë e amortizuar dhe me lagështirë.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut”* si dhe në mbështetje të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”*

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave për zbatimin me korrektesë së dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative, lidhur me formën e urdhrit për vendosjen e të burgosurit në dhomën e veçimit, si masë parandaluese, deri në mbledhjen e komisionit disiplinor.
- Ushtrimin e kontrollit mjekësor të përditshëm për të burgosurit që mbahen në mjediset e veçimit dhe dokumentimin e kontrolleve të përditshme mjekësore, në kartelën klinike të të burgosurit, si dhe në regjistrin e vizitave mjekësore të institucionit.
- Kufizimi i të drejtave të të burgosurve të kryhet vetëm me një akt administrativ të shkruar dhe të arsyetuar, nga titullari i institucionit.
- Përgjithësimin e rastit për të përmirësuar procedurën në të tërë sistemin penitenciar.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të Ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Besnik DEDA

D.V